



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Džakovica - Municipality of Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



GJAKOVA



ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES



Nr.Inv/Br.Inv 01-01101-7982 IV/2
Data/Datum/Date 23.05.2024 Nr.Faqeve/Br.Str./No.Pg. 1
Gjakovë - Džakovica - Gjakova

Datë:	23.05.2024
Për:	Arbënesha Kuqi- Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
KOPJE:	-Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës -Arkivit
Nga:	Ardian Gjini-Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda	Propozim-Vendim për bashkëpunim ndërkomunal me Bashkinë e Lezhës Republika e Shqipërisë

Të nderuar/a,

Duke u Bazuar në nenin 12 shkronja (d) nenin 40 shkronja (j) ,dhe nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal si dhe nenin 6 të Rregullores 0203-1334 të datës 18.12.2012 për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtare, Kryetari i Komunës parashtron Kuvendit të Komunës së Gjakovës këtë :

PROPOZIM VENDIM

1. Të miratohet Nisma e Kryetarit të Komunës së Gjakovës për të hyrë në Bashkëpunim ndërkomunal.
2. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Bashkinë Lezhë Republika e Shqipërisë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës Ardian Gjini për të filluar konsultimet për përgatitjen e marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërkomunal sipas legjislacionit në fuqi .
4. Pjesë përbërëse e këtij Propozim Vendimi është: Nisma për Bashkëpunimin ndërkomunal me Bashkia Lezhë Republika e Shqipërisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01 Nr. Q1161-7983
Dt. 23.05.2024

Në pajtim të nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligji nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, si dhe nenin 5 nën paragrafi 1.1 të Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit ndërkomunal si dhe nenin 5 të Rregullores nr. 0203-1334 të datës 18.12.2012 për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtare, Kryetari i Komunës paraqet kërkesën për miratim:

NISMËN

PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME BASHKINË E LEZHËS

NË FUSHËN E TRASHEGËMISË KULTURORE, TURIZMIT, ARSIMIT DHE TË TJERA

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Bashkinë e Lezhës.
2. **Qëllimi i bashkëpunimit-** Bashkëpunimi do të bëhet në fushën e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit, Arsimit dhe të tjera, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat përkatëse. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshme publik.
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim – vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës.
4. **Arsyetim-**Nisma për bashkëpunim ndërkomunal me Bashkinë e Lezhës Republika e Shqipërisë bëhet me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në mes të dy vendeve në fushat e lartcekura. Duke u nisur nga bashkëpunimi aktual dhe ngjashmëritë socio ekonomike dhe kulturore si dhe në bazë të komunikimeve të vazhdueshme, formalizmi i këtij bashkëpunimi përmes Bashkëpunimit Komunal ndërkombëtar të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Lezhës është shumë i nevojshëm dhe i mirëseardhur.

Kryetari i Komunës së Gjakovës


Ardian Gjini
